



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Raport

Për dhunën ndaj grave dhe veprimtarinë e
Avokatit të Popullit

Korrik 2012

I.Hyrje

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë sanksionon barazinë ndërmjet burrave dhe grave, por në praktikë shpesh gratë nuk i gëzojnë njësoj të drejtat e tyre si burrat. Kjo pabarazi është e prekshme në shumë fusha të jetës.

Deri në vitet '90, Shqipëria nuk ka qenë e angazhuar ndaj instrumenteve ndërkombëtare ose të nivelit europian, ndaj të drejtat themelore të sanksionura në to, shkeleshin sistematikisht.

Përpyekjet e para për studime mbi dhunën në familje në Shqipëri u bënë vetëm në mesin e viteve 1990, ndërkohë që përpyekjet individuale dhe institucionale për të studiuar dhe eksploruar mbi dhunën në familje janë shtuar. Përveç mungesës së eksperiencës së studimeve në këtë fushë, këto përpyekje janë ndeshur dhe përballur me një sërë vështirësish që kanë të bëjnë edhe me natyrën komplekse të fenomenit të dhunës në familje.

Megjithë punën ndërgjegjësuere që është bërë veçanërisht gjatë dhjetë viteve të fundit për të sensibilizuar publikun, qëndrimet ndaj dhunës nuk kanë ndryshuar shumë.

Vështirësia e studimit të fenomenit rritet edhe më shumë po të kemi parasysh se ai ndodh “pas dyerve të mbyllura” të familjes. I vetmi burim informacioni mbetet në shumicën e rasteve vetë viktima, e cila në çdo rast nuk është e çliruar nga paragjykimet dhe stereotipet që ekzistojnë në shoqëri apo në komunitetin ku ajo bën pjesë.

Dhuna ndaj gruas është një problem kompleks që përfshin më shumë se sa një akt në vetvete në marrëdhëniet personale mes burrit dhe gruas. Është një problem social me përmasa të gjera që i ka rrënjët në qëndrimet historike ndaj gruas dhe marrëdhënieve martesore. Viktimizimi i grave nga bashkëshortët e tyre përforcohet nga gjendja ekonomike, mentaliteti dhe tradita, ndërgjegjësimi jo i mjaftueshëm i njerëzve mbi dhunën në familje.

Ndërsa dhuna ndaj gruas po bëhet gjithmonë dhe më shumë problem shqetësues në shoqëri, pasi shumë burra ndihen të kërcënuar nga koncepti i lirisë së grave. Studimi i dhunës në familje vështirësohet po të kemi parasysh edhe një numër mitesh që nuk lejojnë depërtimin në thelbin e problemit. Kështu, në komunitete dhe ambiente të ndryshme sociale ndahen mendime se “dhuna prek vetëm një shtresë apo grupe të caktuara”, “dhuna është një

problem i të varfërve”, “gratë e dhunuara kanë personalitete të caktuara që e nxisin ushtrimin e dhunës nga bashkëshorti”, etj.

Zakonet dhe traditat shqiptare trashëgojnë nga e kaluara disa forma të diskriminimit të gruas në familje dhe në shoqëri, por jo të tipit të torturës, apo të formave të tjera të keqtrajtimit. Dukuria e gjakmarrjes që u rigjallërua pas viteve '90, sidomos në disa zona të vendit, ka sjellë probleme edhe për gratë, por veçanërisht për fëmijët. Gjakmarrja është bërë pengesë për një jetë normale të tyre edhe për shkak të vështirësive që sjell ngujimi i burrave dhe i fëmijëve. Rastet kur për gjakmarrje është qëlluar mbi gruan paraqiten të rralla. “Kanuni”, praktikohet ende në Shqipëri, veçanërisht në Veri. Fatkeqësisht, pas viteve '90, shihet një riaktivizim i këtij kodi.

Marrëdhënia seksuale me dhunë ende konsiderohet “turp” për gruan dhe në disa raste (veçanërisht në zona rurale) passjell martesën e detyruar me përdhunuesin “për të vënë nderin në vend”. Megjithatë, në zonat urbane, situata ka ndryshuar, por në shumicën e zonave rurale e suburbane gruaja vazhdon të jetë nën tryshninë e mendësisë patriarkale.

Dhjetëvjetëshi i parë i tranzicionit, 1990-2000, u karakterizua nga përhapja e dukurisë së trafikimit të grave dhe të vajzave me qëllim ushtrimin e prostitucionit.

Në janar të vitit 2003, Qeveria e Shqipërisë paraqiti për herë të parë raportin e saj për zbatimin e standardeve të Konventës “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj gruas” (CEDAË) e ratifikuar nga Shqipëria në Nëntor të vitit 1993. Problemet e paraqitura si më të ndjeshme ishin prostitucioni dhe trafikimi i grave dhe i vajzave. Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave, pranë OKB-së¹, ka dhënë disa rekomandime, të cilat kanë udhëhequr veprimtarinë jo vetëm të mekanizmave shtetërorë, por edhe veprimtarinë e të gjitha OJF-ve që mbështetin, asistojnë dhe ndihmojnë gratë e dhunuara.

Nga studimet e kryera prej tyre, rezulton se dhuna ndaj gruas në Shqipëri, në pjesën dërrmuese të saj kryhet brenda gjirit të familjes. Të pakta janë rastet e denoncuarat të dhunës ndaj gruas, ushtruar nga institucionet shtetërore. Fatkeqësisht, edhe denoncimet dhe kallëzimet që gratë kryejnë në rastet e dhunës në familje, janë të pakta.

¹ Sesioni i 28 i Komitetit të CEDAË, 13-31 Janar 2003, si dhe me pas vërejtjet e Komitetit të Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas, dhënë në 2010.

Nga monitorimi i shtypit të përditshëm për vitin 2002-2003², rezulton se kanë humbur jetën si pasojë e dhunës së ushtruar brenda familjes 56 gra e vajza në të gjithë Shqipërinë. Kanë pësuar dëme të rënda shëndetësore 74 gra e vajza të tjera. Kjo përqindje e ulët e grave që kanë denoncuar abuzimin, mund të shpjegohet me nivelin e ulët të njohurive. Aktualisht, viktimat e dhunës në familje mbrohen përmes dispozitave të përgjithshme të Kodit Penal, që rregullojnë keqtrajtimet fizike, fyerjen, plagosjen, vrasjen etj. Ndërkohë vepra penale e kryer, duke përfituar nga marrëdhëniet familjare, përbën rrethanë rënduese.

Numri i vogël i ankesave dhe i kallzimeve nga viktimat e dhunës në familje tregon që dhuna në familje vazhdon të konsiderohet çështje private nga publiku.

Gjykatat, gjithashtu, ndikojnë në krijimin e një apatie në familjet ku ushtrohet dhunë, pasi nuk marrin vendime të drejta ndaj kriminelëve (shkelësve të ligjit), si dhe në mjaft raste, vendimi i marrë ndaj autorit janë gjobat, të cilat rëndojnë mbi shpenzimet e familjes.

Kodi i ri i Familjes, forcoi masat antidhunë ndaj grave³ dhe ligji shqiptar “Për shëndetin riprodhues” është një ndër më modernët në Europë dhe një garant i së drejtës së gruas për të vendosur vetë për riprodhimin e saj.

Puna parandaluese, që bëhet nga organizatat jofitimprurëse, është shoqëruar me miratimin e ligjeve përkatëse për dhunën në familje, por edhe me kujdesin për të hetuar dhe gjykuar me rreptësi çdo shfaqje dhune që përbën vepër penale. Duhet të ketë më shumë mjete efektive në kuadrin e një mekanizmi, për të garantuar që të ruhen dhe zbatohen të drejtat e grave, për të përmirësuar trajtimin dhe pozitën e femrave në familje dhe në shoqërinë shqiptare. Gjithashtu organet shtetërore duhet të punojnë për realizimin e detyrimeve të tyre për t’i shkuar drejtësisë deri në fund, pavarësisht se viktimat e kësaj dhune mund të heqin dorë nga akuza për një arsye apo tjetër. Nuk duhet harruar se dhuna në familje nuk është atribut vetëm i familjeve të varfëra apo atyre me shkollim të pamjaftueshëm, si dhe ajo ka prekur dhe prek edhe familjet në gjendje të mirë ekonomike dhe me arsim të lartë.

² *Monitorimi i shtypit i kryer nga Qendra e Gruas 2003-2004, Tirane.*

³ *Kodi i Familjes, ne nenin 61 te tij permban masat urgjente*

II. Dhuna në familje, koncepti dhe format e saj

Dhuna në familje është një problem që prek të gjitha shtresat dhe grupet e shoqërisë, pa dallim race, etnie, niveli ekonomik, zone gjeografike, besimi fetar, moshe, etj. Nga të dhënat në nivel botëror, të mbledhura në dhjetë vitet e fundit rezulton se dhuna ndaj grave është një pengesë në procesin e zhvillimit të shoqërisë njerëzore. Llogaritja e kostove social-ekonomike të dhunës në familje, përbën një ndërhyrje strategjike në ndërgjegjësimin e politikëbërësve për rëndësinë dhe efektivitetin e parandalimit të saj. Duke qenë se dhuna në familje është një çështje tepër sensitive në vende dhe rajone të ndryshme, për adresimin e saj duhen programe dhe strategji në përputhje me kulturën e tyre.

Ekzistojnë një sërë argumentash të cilët kërkojnë të tërheqin vëmendjen e politikbërësve lidhur me marrjen e masave parandaluese dhe luftën kundër dhunës në familje.

Argumenti i drejtësisë: Çdo individ duhet të gëzojë të drejtën themelore për të jetuar i/e lirë dhe i/e paprekur nga dhuna.

Argumente të cilësisë së jetës: Gratë që arrijnë t'i mbijetojnë dhunës së ushtruar nga bashkëshortët, në pjesën më të madhe të rasteve vuajnë nga probleme shëndetësore, psikologjike dhe fizike. Në këto kushte dhuna në familje nuk mund të injorohet si problem social, por edhe shëndetësor.

Argumenti i reagimit zinxhir: Efektet fizike dhe psikologjike të dhunës përfshijnë çdo fushë të jetës. Ajo mund të çojë në izolim social, sjellje josociale, vështirësi ekonomike dhe transmetim të modelit të dhunshëm tek fëmijët⁴. Shteti Shqiptar, në kuadër të detyrimeve ndaj shtetasve të saj duket të respektojë, mbrojë, plotësojë dhe promovojë të drejtën e të gjithë shtetasve për të jetuar një jetë pa dhunë.

III. Format e dhunës në familje

Çfarë është dhuna në familje ?

Dhuna është një term i përdorur gjerësisht, në të cilin përfshihen një sërë sjelljesh e qëndrimesh. Sipas ligjit 9669/2006 (i ndryshuar) “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, me termin “Dhunë” kuptohet çdo veprim

⁴ Astrida Neimans, *Gender mainstreaming in practice; a handbook, UNDP 2002 (fq80-82)*

apo mosveprim i një personi ndaj një personi tjetër, që sjell si pasojë cenim të integritetit fizik, moral, psikologjik, seksual, social, ekonomik.

Gjithashtu po në këtë ligj me termin “Dhunë në familje”, kuptohet çdo akt dhune, sipas përcaktimeve të sipërcituara, i ushtruar midis personave që janë apo kanë qenë në marrëdhënie familjare.

Familja tradicionale, zakonisht përkufizohet nga sociologët si një grup individësh i lidhur nga gjaku ose nëpërmjet martesës, që jeton bashkë, bashkëpunojnë ekonomikisht dhe ndajnë përgjegjësitë për të rritur fëmijët e përbashkët. Familja është gjithashtu një grupim privat individësh, marrëdhëniet dhe sjelljet e të cilëve janë të padukshme për të tjerët; një organizim social kompleks që konsiston në shumëllojshmëri rolesh dhe statusesh; dhe së fundmi marrëdhëniet ndërmjet anëtarëve të një familje janë më intime, më emocionale dhe më të ndjeshme.

Në kohën tonë familja e ka humbur “qetësinë”, dhe është e kërcënuar jo vetëm nga faktorë tradicionalë, si vdekja, sëmundjet, katastrofa të ndryshme, varfëria, etj., por dhe ata “jo tradicionalë” si sjelljet devijante, konfliktet gjithfarëshe, dhuna, alkolizmi, përdorimi abuziv i drogës, braktisja, sëmundjet seksualisht të trasmetueshme, etj”. Pra familja është një strukturë që përmbledh një mori marrëdhëniesh dhe rolesh dhe si e tillë është e ndjeshme nga dhuna që ushtrohet brenda saj.

Duke u bazuar në vlerat universale të familjes, Organizata e Kombeve të Bashkuara e përkufizon dhunën në familje si një akt që rezulton, ose ka shumë mundësi të rezultojë në dëmtim fizik, seksual ose mendor duke përfshirë kërcënime ose akte të ngjashme, shtrëngimet ose heqjen arbitrare të lirisë. Ekzistojnë disa forma të dhunës, ndër të cilat më poshtë janë renditur ato më të përhapurat në Shqipëri, bazuar edhe në përvojën e qendrave të shërbimit në ndihmë të grave dhe vajzave të dhunuara⁵:

Dhunë Fizike përfshin: shtyrje, goditje, gërvishtje, mbylljen në shtëpi, goditje me objekte të forta, kërcënim me thikë ose me armë tjetër, refuzim për ta ndihmuar gruan kur është shtatzënë ose e sëmurë, tentativa për vrasje deri në formën më të rëndë, vrasjen. Forma të dhunës fizike janë edhe përpjekjet për të kontrolluar e monitoruar lëvizjet e gruas. Dhuna fizike në përgjithësi ushtrohet duke filluar nga format më të lehta për të arritur deri tek ato më ekstremet. Dhunuesit janë tepër testues dhe të kujdesshëm me

⁵ World Health Organization, www.who.org

rritjen e nivelit të dhunës. Përgjithësisht kjo formë e dhunës takohet pas vitit të parë të martesës, gjatë shtatzënisë, për t'u përshkallëzuar pas lindjes së fëmijës së parë e për të vazhduar gjatë gjithë jetës bashkëshortore nëse gruaja nuk e kundërshton atë ose nuk gjen një mënyrë për të shpëtuar prej saj. Të dhënat tregojnë se një numër i konsiderueshëm grash, viktimat të dhunës në familje, e kanë përjetuar atë që në familjen e origjinës. Viktimat tregojnë se edhe nënat e tyre janë abuzuar njësoj nga bashkëshortët dhe kurrë nuk e kanë kundërshtuar atë.

Dhunë Psikologjike/Emocionale përfshin talljet, kërcënimet, ndjekjen nga pas, mohimin e hapësirës për të marrë vendime, ndalimi për dalë me shoqërinë apo dhe për të dalë vetëm, kritikën e vazhdueshme ndaj kulturës apo zakoneve, sharjet ndaj viktimës në shtëpi dhe në publik, ngarkimin me faj të viktimës për çdo gjë që shkon keq, etj.

Dhuna Shpirtërore, përfshihet në dhunën psikologjike dhe konsiston në ndalimin e shprehjes së besimit fetar ose normave kulturore, traditave dhe besimit shpirtëror.

Dhuna Seksuale përfshin marrëdhënie seksuale me forcë, trajtimin e partneres si objekt seksual, detyrimin për të bërë seks pa dëshirën e partneres, detyrimin për të bërë seks me një partner tjetër në sy ose jo të vetë bashkëshortit/partnerit, deklarimi për një lidhje jashtëmartesore detyrimi për të kryer marrëdhënie seksuale pas ushtrimit të dhunës fizike, detyrimi për të bërë prostitucion, detyrimi për të bërë striptizëm, etj. Mbështetur nga të dhënat e qëndrave të këshillimit kjo është forma e tretë e dhunës që deklarohet nga gratë viktimat. Në këtë rast duhet nënvizuar fakti se ndonëse një dhunë e pastër seksuale mund të jetë e treta përta përta i përket frekuencës së saj, ajo është gjithnjë e implikuar dhe e gërshetuar me format e tjera të dhunës si dhuna emocionale dhe ajo fizike.

Dhuna Ekonomike përfshin, kontrollin e parave në mënyrë që të mos i lihet viktimës mundësia për të marrë vendime për çështje ekonomike, dhënia e një vlefte të vogël parash që nuk është e mjaftueshme për mbulimin e shpenzimeve ekonomike, refuzimi për të mbuluar shpenzimet e fëmijëve, forcimi për të vjedhur ose shitur gjërat e vlefshme, mohimi i mundësisë që pasuria të jetë edhe në emër të partneres/bashkëshortes etj.

Dhuna ndaj grave ndikon negativisht në zhvillimin ekonomik të një vendi. Në vendet në zhvillim, është llogaritur që pesë për qind e kohës së punës, e

humbur për shkak të paaftësisë së gruas, shkaktohet si rezultat i dhunës së ushtruar në familje.

Është shumë e vështirë të kuptohet niveli i përhapjes së formave të dhunës për shkak të mungesës së studimeve sistematike dhe për shkak të presionit tepër të madh ndaj grave për të ndenjur të heshtura për të tilla krime që kryhen ndaj tyre.

Ngacmimi seksual është përcaktuar nga Komisioni Europian në rekomandimet e tij dhe Kodin e Praktikës në Mbrojtje të Dinjitetit të Grave dhe Burrave në Punë (1991), si “një sjellje e padëshiruar e një natyre seksuale ose sjellje tjetër bazuar në seks duke ndikuar në dinjitetin e grave dhe burrave në vendin e punës”.

Dhuna në familje është një problem i përhapur në shume vende të botes dhe çdo vend ka menyren e vet te percaktimit dhe trajtimit te këtij fenomeni. Menyra se si nje shoqeri e percakton dhunen ne familje varet nga kultura, statusi ekonomik, fetar, ligjor apo pozicioni gjeografik i nje vendi.⁶

Cilat janë arsyet që i mbajnë gratë në këto marrëdhënie të dhunshme?

Frika, kërcënimi për acarimin e dhunës, turpi, stigma, varësia ekonomike, përgjegjësia për fëmijët janë disa nga faktorët që i mbajnë gratë të mos tregojnë eskperienat e tyre të dhunës. Jo rrallë ka ndodhur që gra të dhunuara apo përdhunuara ia kanë treguar historitë e tyre punonjësve sociale, apo profesionistëve të tjerë, të cilët nuk i kanë besuar, i kanë paragjykuar apo i kanë keqtrajtuar duke i marrë në pyetje në mënyrë poshtëruese.

Mbështetës të teorisë feministe kur janë shprehur për dhunën ndaj gruas, kanë konkluduar se frekuenca dhe përhapja e dhunës ndaj gruas dhe mënyrat se si është përballuar apo nuk është përballuar nga institucionet sociale, kërkon një analizë të strukturës sociale. Dhuna e burrave ndaj grave nuk mund të shpjegohet thjesht si akte të izoluara të individëve të veçantë. Një studiues në vitin 1990 (Ealby) thekson: “*Dhuna e burrave ndaj grave është shumë e zakonshme dhe e përsëritur. Dhuna e burrave ndaj grave është një formë e shprehjes së fuqisë së burrave mbi gratë*”.

Megjithëse një sërë faktorësh konvergojnë e përpiqen ta bëjnë dhunën një problem serioz për gratë, problem që i shoqëron ato në jetën e përditshme,

⁶ *Trajtesa juridike dhe sociale per mbrojtjen nga dhuna ne familje, Qendra Avokatore, Tirane (2005)*

që imponon shtrëngime e kufizime në levizjet e tyre dhe i pengon ato të marrin pjesë plotësisht në jetën shoqërore. Këta faktorë përfshijnë qëndrimet kulturore, që janë shumë ambivalente për dhunën ndaj gruas dhe të cilët ruajnë një shkallë të madhe të heshtjes për këtë problem. Sistemet sociale e ligjore, nga të cilat shpesh gratë kanë qenë të përjashtuara historikisht reflektojnë këto qëndrime dhe dështojnë në gjetjen e një përgjigjeje të përshtatshme ndaj këtij problemi. Varësia ekonomike e grave dhe izolimi i tyre në shtëpi për shkak dhe të papunësisë, shpesh e bëjnë të pamundur për gratë t'i rezistojnë dhunës.

III.Çështje ligjore dhe institucionale në lidhje me torturën, keqtrajtimin e gruas dhe dhunën seskuale

III.1.Çështjet ligjore dhe institucionale në lidhje me torturën dhe keqtrajtimin e gruas

Kuptimi i torturës, i dhënë nga Kodi Penal në nenin 86 (ndryshuar me ligjin nr. 9686 datë 26.02.2007 me propozim të Avokatit të Popullit) dhe nenin 87, mbështetet mbi atë çfarë është sanksionuar nga Kushtetuta dhe nuk lidhet posaçërisht me gratë. Përjashtim nga kjo janë rastet kur mbrojtja është e lidhur me disa cilësi të veçanta të subjektit, si mbrojtja e shtatzënisë, që përbën një cilësi natyrore të seksit femër etj.

Kuptimi që i është dhënë torturës në legjislacionin shqiptar, nuk e pengon gjykatën shqiptare të klasifikojë si torturë, në bazë të neneve 86 e 87 të Kodit Penal, dhunën ndaj gruas edhe kur ajo ushtrohet nga një person jozyrtar ose kur ushtrohet brenda familjes. Edhe pse është pranuar ky kuptim, në praktikën gjyqësore rastet kur aplikohen dispozitat e nenit 86 e 87 të Kodit Penal, në përgjithësi janë të rralla dhe në çështje të dhunës në familje mund të mos jenë zbatuar fare. Për të arritur në këtë përfundim na ka ndihmuar monitorimi i vendimeve gjyqësore të gjykatave Tiranë, Shkodër, Vlorë për vitet 2000-2003⁷. Dispozita të tilla janë aplikuar shumë pak në rastet e dhunës në familje. Sidoqoftë, tortura nga subjektet zyrtare si dhe lidhjet familjare përbën një rrethanë rënduese sipas nenit 50 të Kodit Penal.

- *Për veprat penale të parashikuara në nenet 86 dhe 87 të Kodit penal, në lidhje me torturën dhe trajtime apo dënime të tjera mizore,*

⁷ Monitorim nga Qendra per Nisma Ligjore Qytetare

çnjerezore apo poshtëruese, institucionet e drejtësisë hezitojnë të akuzojnë persona të veshur me fuqi zyrtare, p.sh.: oficerë policie ose nëpunës të tjerë.

- *Përgjithësisht, dënimi i personave të përgjegjshëm për keqtrajtim bazohet në nenin 250 të Kodit Penal, i cili bëhet i mundur për veprimet arbitrare.*
- *Hezitimi i gjyqësorit për të zbatuar nenet 86 dhe 87 të Kodit Penal mund të shihet edhe gjatë klasifikimit të veprave penale në lidhje me subjektet e zakonshme të përgjegjshme. Në praktikë, megjithëse dhuna në familje, e ushtruar kryesisht nga burrat, ndonjëherë mund të cilësohet torturë, prokurorët dhe gjyqtarët ballafaqohen me vështirësi për ta cilësuar atë si të tillë. Justifikimi i tyre është mungesa e provave.*

III.2 Çështjet ligjore dhe institucionale në lidhje me dhunën seksuale

Në Shqipëri, krimet seksuale, tradicionalisht, janë konsideruar çënime tepër të rënda dhe të papajtueshme me nderin, moralin dhe respektin ndaj gruas.

Legjislacioni penal shqiptar mbron posaçërisht lirinë seksuale dhe shëndetin e njeriut, duke dënuar rëndë përdhunimin dhe krime të tjera seksuale. Kodi Penal⁸, aktualisht, parashikon 9 figura veprash penale, si krime seksuale ose homoseksuale, të cilat konsiderohen krime kundër jetës dhe shëndetit të personit, për të cilat parashikohen dënime të rënda⁹. Krimet seksuale dhe homoseksuale përmbahen në seksionin VI të Kodit penal, “Krimet seksuale”, i cili është një prej 10 seksioneve të kapitullit II të këtij Kodi, “Veprat penale kundër personit, krimet kundër jetës”. Krimet seksuale dhe homoseksuale janë parashikuar në të njëjtin seksion. Gjithsesi, ka disa dispozita të veçanta, siç është rasti në nenin 102 dhe 102/a, i cili përkatësisht parashikon rastet e marrëdhënieve seksuale me të mitur. Ato ndryshojnë vetëm për sa u përket dënimit¹⁰.

Me Ligjin 8733, datë 24.1.2001, i cili amendoi Kodin Penal, u plotësua një sistem i tërë që siguron njësimin e përgjegjësisë penale për krimet seksuale ose homoseksuale, në të cilin bazohet cilësimi si veprime të kundërligjshme me dashje, që cenojnë lirinë seksuale dhe shëndetin e femrës apo të mashkullit. Jeta dhe shëndeti i grave dhe vajzave (duke përjashtuar të

⁸ Kodi Penal i RSH, ka hyre ne fuqi ne vitin 1995 dhe eshte amenduar disa here.

⁹ Krimet seksuale perbejne seksionin VI te kreut “Vepra penale kunder personit, krime kunder jetes”, kreu II i Kodit Penal.

¹⁰ Po aty.

miturat, të cilat gëzojnë mbrojtje të veçantë) mbrohen nga krimet seksuale përmes disa dispozitave.

Në këndvështrimin bashkëkohor, Kodi Penal aktual paraqitet më i plotësuar në goditjen e krimeve seksuale dhe homoseksuale, në raport me të gjitha kodet apo ligjet penale të mëparshme. Të gjitha rrethanat e veçanta në të cilat mund të kryhen marrëdhëniet seksuale ose homoseksuale me dhunë, si dhe veprat e turpshme, klasifikohen si figura krimi më vete dhe jo si rrethana të cilësuar të kryerjes së krimit. Të gjitha veprat e klasifikuara si më sipër, paraqiten si krime dhe kryerja e njërit prej tyre pasohet nga dënime të rënda. Dënimet janë më të rënda nëse veprat penale kryhen në rrethana rënduese. Prej këtyre parashikimeve bëjnë përjashtim marrëdhëniet seksuale ose homoseksuale në vende publike. Në përgjithësi veprat penale të sipërcituara, përbëjnë çështje të juridiksionit të gjykatave të zakonshme¹¹.

Marrëdhënia seksuale me dhunë me të rriturat parashikohet si figurë e veçantë krimi në Kodin Penal. Karakteristikë për këtë figurë është se ajo kryhet me anën e dhunës, e cila duhet të verifikohet përmes provave. Dhuna është elementi kryesor i figurës së veprës penale dhe kërkon medoemos kundërshtimin e së dëmtuarës. Përveç dhunës fizike (rrahja, goditja, të lidhurit etj.), jurisprudenca pranon edhe dhunën psikologjike. Gjithsesi, dhuna psikologjike është pranuar si provë vetëm në rastet kur ka kanosje serioze për vrasje ose plagosje të rëndë. Gjithsesi, kanosja nuk përfshin përdorimin e armëve të zjarrit, që përbën një figurë tjetër krimi (neni 104). Nga praktika rezulton gjithashtu, se vepra penale konsiderohet e mbetur në tentativë, nëse subjekti i veprës nuk e mposht viktimën.

Në rrethana të zakonshme, marrëdhënia seksuale me dhunë me të rritura dënohet me burgim nga tre gjer në dhjetë vjet. Gjithsesi, dënimi rritet në rast se vepra penale kryhet në bashkëpunim, më shumë se një herë ose kur shëndeti i së dëmtuarës dëmtohet rëndë. Dënimi më i rëndë për subjektin që kryen veprën, është nga dhjetë deri në 20 vjet burg dhe jepet kur kjo vepër ka sjellë si pasojë vdekjen ose vetëvrasjen e viktimës. Në mënyrë analoge, neni 102 i Kodit Penal është shtuar me nenin 102/a të Kodit Penal, i cili parashikon të njëjtat sanksione për marrëdhëniet homoseksuale me dhunë me të rritur.

¹¹ Gjykata e Krimeve të Rënda, e krijuar në vitin 2004, ka juridiksion vetëm për rastet e konsideruara mjaft të rënda, të parashikuara në nenet 100 dhe 101 të Kodit penal, përkatësisht në rastet e marrëdhënieve seksuale ose homoseksuale me të miturat dhe të marrëdhënieve seksuale ose homoseksuale me dhunë me të mitura.

Në mbrojtjen e grave dhe të vajzave të rritura ndihmon edhe neni 105 i Kodit Penal, i cili parashikon si figurë krimi marrëdhëniet seksuale ose homoseksuale duke shpërdoruar detyrën. Kjo figurë karakterizohet nga subjekte që kanë cilësi të posaçme, marrëdhënien e varësisë ose të detyrës me viktimën. Dënimi i parashikuar për këtë vepër shkon deri në tre vjet burgim. Ky nen është një dispozitë tipike që parashikon dhe dënon abuzimet seksuale të personave që përdorin dhe shpërdorojnë detyrën. Raportet e varësisë presupozohen në marrëdhëniet e punëdhënësit me punëmarrësin, por edhe lidhje të tipit të tillë, si mësues-nxënës. Viktima e këtij krimi mund të jetë edhe personi i mitur, mjaft që ai të ketë mbushur moshën 14 vjeç dhe ka arritur pjekurinë seksuale. Edhe pse duket një dispozitë mjaft efikase, në praktikë përdoret rrallë, pasi në këto raste denoncimet kanë qenë të pakta. Më të pakta kanë qenë rastet e paraqitura si çështje në gjykata¹². Praktika ka krijuar edhe raste që kryhen në rrethana specifike, të paparashikuara shprehimisht në dispozitat e mësipërme.

Probleme që evidentohen:

1. Gratë përbëjnë shumicën e viktimave të dhunës seksuale dhe ato kanë barrën e provës në rastin kur abuzimi seksual ndodh. Gjithsesi, provat mblidhen përmes një raporti mjekësor dhe shpesh nuk bëhen hetime të menjëhershme tërësore. Për më tepër, dhuna psikologjike është tepër e vështirë të provohet dhe shpesh i lë autorët të pandëshkuar. *Dhuna përbën elementin kryesor të veprës penale dhe, kur viktima nuk mund të tregojë prova të shenjave të dhunës, krimi nuk mund të provohet.*

2. Në praktikë ndodh të kërkohej nga viktima pikërisht të tregojë nëse e ka provokuar apo jo subjektin e krimit.

3. *Abuzimet seksuale për shkak të shpërdorimit të varësisë ose të detyrës mbeten shpesh të heshtura dhe të padenoncuar.* Ndërkohë, pozita zyrtare shpërdorohet edhe në rastet kur nuk ka ndonjë varësi të drejtpërdrejtë.

4. *Çështja e dëmshpërblimit përmes padisë civile në procesin penal përgjithësisht vazhdon të mos ketë vëmendjen e duhur.* Kjo kërkon angazhim të madh, mjete financiare për të paguar një avokat, pasi edhe pse legjislacioni procedural e parashikon diçka të tillë, gjyqtarët nuk pranojnë shqyrtimin e padisë civile brenda procesit penal.

¹² Nga vjetari statistikor i 2003 rezulton se janë denoncuar 19 vepra penale për marrëdhënie seksuale me dhunë.

5. Në praktikë, nuk ndeshen raste të denoncimit të dhunës seksuale midis bashkëshortëve, ndërkohë që jo rrallë ajo është bërë shkak për divorcet. Kodi Penal nuk parashikon dispozitë të veçantë për marrëdhëniet seksuale me dhunë mes bashkëshortëve, por, nëse bashkëshortja vendos të denoncojë dhunën seksuale të ushtruar nga bashkëshorti i saj, ajo mund t'i referohet për t'u mbrojtur nenit 102 të këtij Kodi.

III.3 Çështje ligjore dhe praktike lidhur me trafikimin e grave dhe të vajzave

Mendojmë se trafikimi i grave, i kryer kundër vullneti të gruas, është një nga format e dhunës që ushtrohet ndaj grave në shoqëri. Në raporte dhe vlerësime të kryera nga autoritetet shtetërore përgjegjëse, organizata jofitimprurëse vendase, por edhe nga organizata ndërkombetare, është konstatuar që ka patur raste kur trafikimin e kanë mbështetur vetë familjarët e të trafikuarave, për nevoja ekonomike të tyre.

Shkaqet e përhapjes së trafikimit të grave dhe të vajzave në 20 vitet e fundit janë të shumta dhe lidhen me dobësinë e shtetit për të goditur dukuri, si trafikimi. Në vitet 1990-2000, shoqëria shqiptare u mbërthye nga një varg problematikash, si: varfëria ekonomike, papunësia, emigrimi, lëvizja e lirë e njerëzve etj. Të motivuar nga fitimi në këtë veprimtari të kundërligjshme, trafikantët kanë përdorur forma të tilla, si: mashtrimi me premtim për punë, martesat e rreme etj. Ka Shumica e viktimave të trafikimit janë gra dhe vajza të moshës rreth 21 vjeç¹³.

Ndërkohë, angazhimi dhe sensibilizimi i shtetit, i organizmave ndërkombëtarë dhe i organizatave jofitimprurëse kombëtare ose ndërkombëtare për të luftuar dukurinë e trafikimit në Shqipëri është rritur. Këtij angazhimi i është përgjigjur përmirësimi i vazhdueshëm i situatës ligjore. Qeveria shqiptare ka hartuar strategjinë e luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore si dhe ka krijuar mekanizma që të mundësojnë realizimin e saj. Pranë Ministrisë së Brendshme ndodhet Njësia e Antitrafikimit, e cila koordinon punën e saj me Policinë e Kufirit, me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë dhe me struktura analoge në vende të tjera, apo me agjenci të ndryshme shërbimesh.

¹³ *Shoqëria Shqiptare perballë sfidave të trafikimit të grave dhe femijëve, Tirane 2004 (4 autore)*

Gjatë viteve 2000-2004 u mor një nismë intensive për ndalimin e transportimit të paligjshëm të njerëzve përmes skafeve për në Itali, që uli ndjeshëm dyndjen e trafikimit të qenieve njerëzore.

Organet e policisë gjyqësore pranë Ministrisë së Brendshme kanë qenë të suksesshme në riatdhesimin dhe dorëzimin e femrave të trafikuar familjeve të tyre, por gjithsesi, gratë janë riatdhesuar pasi kanë siguruar informacion për identitetin e personave që i kanë shfrytëzuar. Ky informacion i hap rrugën prokurorisë dhe gjykatës për trajtimin me efektivitet të kësaj çështjeje.

Bazuar në Vendimin nr.589, datë 28.8.2003, “Për krijimin dhe bërjen funksionale të qendrës pritëse të viktimave të trafikimit”, një strehëz shtetërore është hapur në Linzë, e cili siguron një mbështetje për viktimat e trafikimit dhe i ndihmon ato jo vetëm për goditjen e trafikantëve, por edhe nga ritrafikimi.

Ndihmë të veçantë kanë dhënë edhe organizatat jofitimprurëse, ndërkombëtare ose kombëtare, të cilat kanë ofruar strehim, ndihmë për rehabilitimin, si dhe ndihmë ligjore për gratë dhe vajzat e trafikuar. Spikatin veprimtaritë e organizatës ndërkombëtare IOM, si dhe e strehëzave (ku spikat strehëza “Vatra” në Vlorë). Mundësimi i strehëzave pranë organizatave jofitimprurëse është realizuar si rezultat i mbështetjes financiare nga jashtë.

IV. Ligji “Per masat ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare” dhe aktet ndërkombëtare

Miratimi dhe hyrja në fuqi e Ligjit “Per masat ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare”, ndryshimet e tij më 2007, dhe më tej më 2010 është një hap i rëndësishëm drejt plotësimit të kuadrit ligjor në fushën e dhunës në familje. Dy janë drejtimet e tij të rëndësishme:

Së pari ai sanksionon organet shtetërore që kanë detyrime dhe kompetenca për t’iu përgjigjur dhunës në familje.

Së dyti, ligji i jep mundësi gjykatave të lëshojnë urdhra mbrojtjeje kundër dhunuesit, një mekanizëm shtesë në mbrojtje të viktimave të dhunës në familje.

Në tetor 2010 Kuvendi i Shqipërisë miratoi disa ndryshime të tjera në ligjin “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” të mbështetura nga rrjeti i shoqatave kundër dhunës me bazë gjinore dhe trafikimit, Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim dhe Agjencia e Kombeve të Bashkuara për Gruan. Këto amendamente kishin të bënin me ngritjen e një strehëze kombëtare për viktimat e dhunës në familje, si dhe rregullimin ligjor të sistemit të reagimit të koordinuar dhe të referimit ndaj rasteve të dhunës në familje.

Ligji “Për Dhunën në Familje” përcakton dy lloj autoritetesh përgjegjëse, ato administrative dhe gjyqësore. MPCSSHB është autoriteti kryesor përgjegjës me rol koordinues, mbështetës dhe mbikëqyrës. Autoritetet e tjera përgjegjëse, si Ministria e Brendshme, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Arsimit adresojnë rastet e dhunës në familje nëpërmjet strukturave në varësi të tyre, si dhe trajtojnë problematikat e tyre në përputhje me funksionet dhe kompetencat që ky ligj u parashikon. Ligji përveç përgjegjësive dhe kompetencave që ju adreson këtyre organeve qendrore, parashikon një sere detyrash dhe përgjegjësish edhe për njësitë e qeverisjes vendore. Sipas nenit 7 të ligjit njësitë e qeverisjes vendore (bashkitë, komunat) kanë për detyrë angazhimin në krijimin e strukturave të shërbimit social për rastet e dhunës në familje; instalimin e një linje telefonike rajonale 24-orëshe, e cila më pas krijon lidhje me njësitë lokale, policinë, urgjencat mjekësore dhe OJF-të, duke vendosur në këtë mënyrë edhe koordinimin mes tyre; ngritjen e qendrave sociale dhe të rehabilitimit për viktimat dhe dhunuesit, si dhe koordinimin e punës me ato ekzistuese, duke u dhënë përparësi qendrave të specializuara në fushat përkatëse.

Me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 723, datë 20.10.2011, u miratua në parim nga Këshilli i Ministrave, Konventa e Këshillit të Europës “Parandalimi dhe lufta kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”.

Objektivi i kësaj konvente është zbatimi i saj për të gjitha viktimat e dhunës në familje sidomos duke i kushtuar vëmendje e veçantë gratë që vuajnë më shumë dhunën në familje në të gjitha format e saj. Kjo Konventë është e hapur për ratifikim që nga 11 Maji 2011, dhe e kanë nënshkruar rreth 18 shtete. Aktualisht sipas informacionit të dërguar zyrtarisht nga MPCSSHB, po ndiqen procedurat për ratifikimin e kësaj konvente, e cila mendohet të ratifikohet gjatë gjashtë mujorit të dytë të vitit 2012, gjatë Presidencës së Shqipërisë në Këshillin e Europës.

Gjithashtu me Vendim të Këshillit të Ministrave është miratuar Strategjia e Barazisë Gjinore, Reduktimit të Dhunës me Bazë Gjinore dhe Dhunës në Familje 2011-2015. Strategjia ka parashikuar në planin e saj të veprimtari masa konkrete për reduktimin e dhunës në marrëdhëniet familjare.

IV. Autoritetet shtetërore përgjegjëse në nivel qendror, që promovojnë dhe sigurojnë mbrojtjen e të drejtave të grave

Autoriteti përgjegjës në nivel qendror që promovon dhe siguron mbrojtjen e të drejtave të grave, është Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta. Promovimi i të drejtave të grave dhe arritja e barazisë gjinore në shoqëri, është një nga politikat prioritare e më të rëndësishme, rëndësishme të shoqërore shqiptare. Pikërisht për këtë arsye është e nevojshme që lidhur me këto çështje të ketë një mekanizëm qeveritar që garanton me efektivitet të drejtat e grave.

Në Ministrinë e Punës dhe Çështjeve Sociale e Shanseve të Barabarta funksionon Drejtoria e Politikave të Shanseve të Barabarta, e cila ka si mision kryesor të saj: “formulimin dhe zhvillimin e politikave për nxitjen e barazisë në fusha të tilla si, barazia gjinore, barazinë/ pabarazinë në aftësi, problemet e pakicave etnike, etno- kulturore dhe gjuhësore, pabarazinë moshore, atë brezore e racore etj”. Në veçanti për çështjet e barazisë gjinore Drejtoria ka për qëllim: “të nxisë barazinë gjinore dhe një pjesëmarrje të gjerë të gruas në jetën ekonomike, politike e kulturore të vendit”.

Në nivel parlamentar, brenda Komisionit Parlamentar të Punës dhe Çështjeve Sociale, funksionon Nën/komisioni për Minorenët dhe Shanset e Barabarta, i cili sipas problematikës që mbulon shqyrton dhe ndërmerr inisiativa ligjore. Ky nënkomision bashkëpunon me MPÇSSH, por edhe me të gjithë aktorët e tjerë, të cilët mund të kontribuojnë në çështjet e mbrojtjes së të drejtave të grave, barazisë gjinore dhe fëmijëve.

Kuvendi i Shqipërisë, duke njohur detyrimin e shtetit për të promovuar dhe mbrojtur të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, sipas të gjitha akteve ndërkombëtare dhe legjislationit të brendshëm, duke e trajtuar dhunën në familje si shkelje e të drejtave të njeriut dhe si një çështje që i përket gjithë shoqërisë, duke e konsideruar dhunën ndaj grave jo vetëm si një problem që lidhet me shëndetin publik, por si shprehje e pabarazisë gjinore në familje dhe shoqëri, duke e vlerësuar dhunën si një çështje komplekse që ka nevojë për një ndërhyrje multidisiplinare dhe të vazhdueshme, duke mbështetur fuqimisht veprimtarinë e autoriteteve shtetërore përgjegjëse dhe shoqërisë

civile për mbrojtjen e të drejtave të grave dhe luftën kundër dhunës në familje, *ka ripërsëritur angazhimin dhe vendosmërinë, për domosdoshmërinë e kontributit të deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë për të përmirësuar dhe rritur efikasitetin e legjislacionit për parandalimin dhe ndëshkimin e dhunës ndaj grave e dhunës në familje dhe për të mbikëqyrur zbatimin e këtij legjislacioni që synon eliminimin e dhunës në familje*, për të rritur kontributin e Kuvendit në ndërgjegjësimin e opinionit publik, lidhur me konsiderimin e dhunës në familje si shkelje të të drejtave të njeriut.

Këshilli Kombëtar i Barazisë Gjinore¹⁴ ka për detyrë të këshillojë Qeverinë për përcaktimin e drejtimit të politikave shtetërore për barazi gjinore, me përjashtim të çështjeve që merren në shqyrtim nga Këshilli Kombëtar i Punës dhe të sigurojë integrimin gjinor në të gjitha fushat.

Siç edhe u shprehëm më lart, Ligji “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, përcakton dy lloj autoritetesh përgjegjëse, ato administrative dhe gjyqësore.

Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta si autoriteti kryesor përgjegjës (N. 5/1 dhe N. 6). Ajo ka rol koordinues, mbështetës dhe mbikqyrës. Detyrat e Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta janë, të përcaktojnë drejtimin e politikave shtetërore, të financojnë projekte për viktimat e dhunës dhe mbrojtjen e familjes, të mbështesë ngritjen e strukturave ndihmëse të infrastrukturës dhe mbikqyrjes së këtij procesi, të trajnojnë, të mbajnë statistika, të mbështesë dhe mbikqyrë qendrat e shërbimeve, të liçensojnë OJF-të. Strategjia e rishikuar është konceptuar mbi analizën dhe trajtimin e dy çështjeve të rëndësishme: barazia gjinore dhe reduktimi i dhunës me bazë gjinore. Strategjia synon të bëjë përpjekje drejt arritjes së barazisë gjinore në Shqipëri, nëpërmjet integritit të perspektivës gjinore në të gjitha aspektet e hartimit dhe zbatimit të politikave. Kjo do të thotë pjesëmarrje e barabartë e grave dhe vajzave, burrave dhe djemve në jetën sociale, ekonomike e politike të vendit, si dhe mundësi të barabarta për të gëzuar të gjitha të drejtat e tyre dhe për të vënë në shërbim potencialet e tyre individuale në dobi të shoqërisë, të përmirësojë mbrojtjen, reagimin e autoriteteve publike dhe mbështetjen për viktimat e dhunës me bazë gjinore, si dhe të theksojë punën parandaluese, duke adresuar shkaqet e dhunës dhe abuzimit në familje dhe shoqëri. Për

¹⁴ VKM nr.122, datë 2.2.2009 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjinore”, drejtohet nga Ministri që mbulon çështjet e barazisë gjinore (aktualisht nga Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta)

realizimin e funksioneve të parashikuara edhe në këtë ligj Drejtoria e Politikave për Shanset e Barabarta dhe Familjen, është përgjegjëse për formulimin dhe zhvillimin e politikave dhe programeve si dhe hartimin dhe rishikimin e legjislacionit në funksion të nxitjes së barazisë gjinore, në shoqëri, parandalimit dhe luftës kundër dhunës ndaj grave, përfshirë dhunën në familje, mbrojtjen nga diskriminimi për shkak të orientimit seksual si dhe për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Brenda kësaj drejtorie sektori për barazinë gjinore dhe masat ndaj dhunës në familje ka si mision të nxisë barazinë gjinore dhe një pjesëmarrje të gjërë të gruas në jetën ekonomike, politike e kulturore të vendit si dhe formulimin dhe zhvillimin e politikave për parandalimin dhe reduktimin e dhunës në marrëdhëniet familjare, e në përgjithësi të dhunës me bazë gjinore.

Gjithashtu sipas nenit 8 të ligjit 9669/2006, autoritetet shtetërore përgjegjëse (MPÇSSH, MSH, MB, MASH dhe MD), kanë për detyrë krijimin e strukturave të posaçme dhe caktimin e personave përgjegjës për zbatimin e këtij ligji. Nga informacionet e marra për këtë çështje kemi konstatuar se jo në të gjitha autoritetet e sipërpërmendura janë ngritur struktura të posaçme për këtë çështje (si në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës), por personave të caktuar në përshkrimin e tyre të punës ju janë vendosur edhe detyra lidhur me zbatimin e këtij ligji.

Gjatë procesit të vlerësimit të Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore kundër Dhunës në Familje 2007-2010 (proces që i parapriu hartimit të Strategjisë së re 2011-2015), nga një vështrim i strategjive, politikave dhe planeve të veprimit të hartuara pas miratimit u vu re se dokumentet e përpunuara dhe miratuara nga Ministria e Shëndetësisë, që ka një nëpunës gjinore të emëruar me kohë të plotë, ishin dukshëm më të ndjeshme nga pikëpamja gjinore se dokumente të ngjashme të përpunuara nga dikastere të tjera. Në përputhje dhe me rekomandimet e Konventës mbi Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, prania e burimeve të tilla njerëzore mundëson zbatimin efektiv të Strategjisë së rishikuar dhe planeve të veprimit për çdo instancë qeveritare.

Në ushtrim të kompetencave të parashikuara në ligjin nr.8454/1999 “Për Avokatin e Popullit”, **institucioni i Avokatit të Popullit** ushtron funksionet e tij për promovimin, mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut (përfshirë edhe të grave), ndaj veprimeve ose mosveprimeve të parregullta dhe të paligjshme të organeve të administratës publike dhe personave të tretë të lidhur me të. Pra, Avokati i Popullit bazuar

në ankesën/kërkesën apo edhe me iniciativë të tij mund të fillojë një çështje, bazuar në pretendimet e paraqitura apo të bëra publike (në rastet e filluara me iniciativë). Ankesat/kërkesat mund të jenë të lidhura me respektimin nga organet e administratës publike të të drejtave apo lirive themelore, si të drejtën e jetës, të drejtën e organizimit në organizata shoqërore, të drejtën e tubimeve paqësore, të drejtën për punësim, të drejtën për sigurime shoqërore dhe shëndetësore etj. Pra nga institucioni ynë trajtohet çdo ankesë/kërkesë apo shqetësim i bërë publik, për mohimin e një të drejte të caktuar, për çdo rast, me përjashtim të rasteve kur pretendohet se ky mohim i të drejtës është bërë për shkaqe të lidhura me gjininë.

Me hyrjen në fuqi të Ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”¹⁵, u krijua edhe **Institucioni i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi**, i cili kryen funksionet e një mbrojtësi të të drejtave, për çështje të diskriminimit për çfarëdo shkak, përfshi gjininë, por edhe identitetin gjinor, shtatzaninë, orientimin seksual, gjendjen familjare apo martesore, përgjegjësinë prindërore, të cilat tipikisht janë të lidhura ngushtë me gjininë e personit. Ky institucion ka kompetencë të shqyrtojë ankesat për diskriminim nga individët, grupet e tyre apo organizatat, të kryejë hetime, të monitorojë zbatimin e këtij ligji, të vendosë sanksione, të zhvillojë aktivitete ndërgjegjësimi dhe edukimi që ndihmojnë në zbatimin e këtij ligji.

Përvojat lidhur me buxhetimin gjinor në nivel lokal kanë evidentuar nevojën për zhvillimin e kapaciteteve në autoritetet lokale, të tilla që të sigurojnë aplikimin e praktikës së buxheteve gjinore. Për më gjerë, një analizë gjinore e strategjive sektoriale do të mundësonte adresimin e duhur të nevojave dhe të të drejtave të grave dhe të burrave në sektorë të ndryshëm të ekonomisë dhe shoqërisë.

IV.1. Monitorimi i legjislacionit dhe politikave.

Udhëzimi i Ministrisë të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta nr.1220, datë 27.5.2010 “Për përcaktimin e treguesve të vlerësimit dhe të monitorimit të treguesve të barazisë gjinore dhe dhunës ndaj grave, përfshirë dhunën në familje, mbikëqyrjen, mbledhjen dhe përpunimin e tyre”, ka përcaktuar treguesit dhe indikatorët për matjen e tyre, periodicitetin e mbledhjes së të dhënave bazuar në këta tregues gjinorë, si dhe autoritetet shtetërore përgjegjëse për mbledhjen dhe evidentimin e këtyre të dhënave.

¹⁵ Ligji nr. 10 221, datë 4.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

Nga ana tjetër, monitorimi konsiston edhe në analizën se sa ndikim ka pasur legjislacioni i barazisë gjinore, çfarë mospërputhjesh janë evidentuar dhe si janë adresuar ato për të siguruar që zbatimi i këtij legjislacioni të çojë në eliminim efektiv të diskriminimit kundër grave, sidomos grave që u takojnë grupeve të disavantazuara (gratë e minoriteteve etnike dhe gjuhësore, gratë me aftësi të kufizuara, gratë e moshuara, gratë që jetojnë në zonat rurale ose në zona të largëta, gratë emigrante, gratë që jetojnë me HIV/AIDS, dhe gratë që diskriminohen mbi bazën e orientimit të tyre seksual dhe identitetit gjinor).

Institucioni i Avokatit të Popullit ka një rol të rëndësishëm në monitorimin e zbatimit të legjislacionit dhe masave që kanë marrë autoritetet shtetërore përgjegjëse për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të grave, në përputhje me fushën e tyre të veprimtarisë. Gjithashtu një vëmendje e veçantë i është kushtuar edhe monitorimit të aktivitetit që kryejnë organet e administratës publike, për mbrojtjen dhe trajtimin që i ofrohet kategorive të veçanta të grave të cilat sipas nenit 54, paragrafi 1 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (grave shtatzëna dhe nënave të reja). Në këtë kontekst përmendim monitorimin e institucioneve ku ofrohet shërbim shëndësor (ambulator dhe spitalor), si dhe i aktivitetit inspektues të Inspektoratit Shtetëror të Punës.

Në vitin 2009, Instituti i Statistikave¹⁶ së bashku me Programin e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim dhe Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët ndërmorën një vërtetim kombëtar mbi dhunën në familje. Ky ishte vërtetimi i parë kombëtar, i cili ofroi shifra të plota e të detajuara mbi dhunën në familje. Ai tregoi se nga 2590 gra të intervistuar, të paktën 56% pohuan se kishin pësuar një nga format e dhunës në familje. Lidhur me faktorët e riskut, vërtetimi nxori në pah se gratë të cilat nuk punonin jashtë shtëpisë kishin dukshëm shumë më tepër mundësi të përjetonin abuzim emocional sesa gratë të cilat punonin jashtë shtëpisë në kohën e vërtetimit (82,5% kundrejt 4,3%); gratë me arsim universitar (46,0%) kishin më pak gjasa të përjetonin abuzim psikologjik krahasuar me gratë me arsim të mesëm (56,2%), me arsim nëntëvjeçar (56,9%), me arsim fillor (62,5%) dhe me ato të paarsimuara (66,7%). Po ashtu gratë me arsim universitar kishin shumë më pak gjasa të keqtrajtoheshin fizikisht apo të abuzoheshin emocionalisht nga bashkëshorti/partneri i tyre krahasuar me gratë me një nivel më të ulët arsimor. Gratë me arsim fillor (70,4%) ishin ato që raportuan më së shumti dhunën fizike të ushtruar ndaj tyre nga bashkëshorti/partneri i tyre. Gratë në

¹⁶ëëë.instat.gov.al

zonat rurale, dëshmonin më shumë për dhunën emocionale dhe fizike, sesa gratë që jetonin në qytet.

Është e dokumentuar se gratë e dhunuara nuk përjetojnë vetëm një formë të dhunës në familje,—emocionale, psikologjike, fizike ose seksuale, por shpeshherë ato përjetojnë njëherazi forma të shumëfishta të dhunës. Abuzimi emocional është një parashikues i llojeve të tjera të abuzimit dhe dhunës në martesën ose lidhjen intime. 82% deri në 88% e grave të cilat kishin përjetuar dhunën në familje raportuan se dhuna – emocionale, psikologjike, fizike dhe/ose seksuale kishte filluar brenda tre viteve të para të martesës ose të bashkëjetesës me bashkëshortin ose partnerin intim. Nga gratë që raportuan paaftësi për të punuar për shkak të prerjeve, maviosjeve dhe dhembjeve, 81,6% kishin vuajtur paaftësi të përkohshme për punë për një deri në katër ditë. Gratë e dhunuara nuk kërkojnë ndihmë nga organe të specializuara. 90,7% kanë kërkuar ndihmë nga familja e tyre, 34,0% kanë kërkuar ndihmë nga familja e bashkëshortit/ partnerit të tyre dhe 13,9% kanë kërkuar ndihmë nga të afërm të tjerë. Pra, nga ky vrojtim vihet re ende një hezitim i grave për ta ngritur problemin e tyre përtej rrethit familjar. Dhuna në familje ndaj grave nuk ndodh gjithmonë nga bashkëshortët/partnerët aktualë ose të mëparshëm. Anëtarë të tjerë të familjes (p.sh. prindërit, vëllezërit, motrat, krushqit dhe të afërm të tjerë) kryejnë akte të dhunës fizike ndaj grave. Edhe pse shpeshherë dhuna pakësohet me zgjidhjen e martesës, 60% deri në 67% e grave të divorcuara ose të ndara, raportuan se aktualisht ato përjetojnë një nga format e abuzimit emocional, krahasuar me 85% deri në 96% të grave të martuara ose të atyre që jetonin me një partner intim.

Shpesh dhuna ndaj grave dhe ajo ndaj fëmijëve bashkëjetojnë në familje. Fëmijët janë viktimat e harruara të dhunës në familje. Në vrojtim u konstatua se prej 146 fëmijëve që kishin qenë të pranishëm në akte dhune në familje, vetëm 23,6% i kanë thënë dikujt për këtë dhunë. Nga i njëjti vrojtim raportohet se nga 991 fëmijët e anketuar, 57,7% raportuan se ishin rrahur fizikisht nga një anëtar i familjes. Fëmijët në zonat rurale (66,4%) kishin më shumë gjasa që të goditeshin me shuplakë, me grusht ose me shkelm nga një anëtar i familjes krahasuar me fëmijët në zonat urbane (50,4%). Në dhunën e ushtruar ndaj fëmijëve u vunë re edhe dallime gjinore. Kështu, djemtë kishin më shumë gjasa se vajzat të përjetojnë dhunë fizike në familje. Në përputhje me konkluzionet e literaturës botërore se gratë e dhunuara kanë më shumë gjasa të dhunojnë fëmijët e tyre sesa gratë që nuk përjetojnë dhunë, vrojtimi

vuri në dukje se dhuna ndaj fëmijëve ushtrohej kryesisht nga nëna (ose njerka), e pasuar nga babai (ose njerku) dhe vëllezërit e motrat.

Gjithashtu, vihet re se baballarët dhunojnë më shumë djemtë e tyre sesa vajzat, ndërsa nënat dhunojnë më shumë vajzat, sesa djemtë, gjë që mund të jetë një tregues i ndarjeve gjinore të roleve të prindërve në “disiplinimin” e bijve apo bijave të tyre. Një fakt tjetër me rëndësi që u evidentua nga vrojtimi kombëtar i dhunës ishte lidhja mes nivelit arsimor të bashkëshortit me dhunën ndaj gruas. Gratë të cilat raportnin se nuk dhunoheshin emocionalisht, psikologjikisht, fizikisht apo seksualisht nga bashkëshorti, më së shumti raportnin edhe se bashkëshorti i tyre ishte me arsim të lartë.

IV.2. Zhvillimet në zbatim të ligjit 9669/2006 (i ndryshuar)

Pavarësisht zhvillimeve në legjislacionin dhe politikat për mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave të grave, sfida kryesore mbetet forcimi i mekanizmit institucional dhe ligjor.

Në aspektin *ligjor*, mbetet sfida harmonizimi në vazhdimësi i legjislacionit me standardet ndërkombëtare, si dhe rritja dhe monitorimi i zbatimit të legjislacionit aktual për barazinë gjinore në Shqipëri nëpërmjet inspektorateve të ngarkuara të bëjnë kontrollin e tij, si p.sh. Inspektorati i Punës, Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektorati Kombëtar i Arsimit Parauniversitar, etj.

Në aspektin e *mekanizmit institucional*, sfidat kryesore mbeten burimet e pamjaftueshme njerëzore për integrimin gjinor, emërimi me kohë të plotë dhe rrjetëzimi i Nëpunësit Gjimore në nivel qendror dhe lokal, ngritja e kapaciteteve të tyre për të bërë analiza dhe programime sipas parimit të integritimit gjinor, si dhe ndërtimi i një njësie të specializuar për të monitoruar progresin e Strategjisë. Gjithashtu në të njëjtin kontekst rëndësi marrin edhe përcaktimi i strukturave apo personave të specializuar pranë autoriteteve shtetërore përgjegjëse për trajtimin e çështjeve të dhunës në marrëdhëniet familjare.

Sipas ligjit 9669/2006, Ministria e Brendshme ka për detyrë ngritjen e sektorëve të veçantë kundër dhunës në familje në çdo drejtori policie, të krijojë struktura të posaçme dhe të caktojë personat përgjegjës për zbatimin e këtij ligji (mund të jetë edhe në nivelin e postës) (N8/1), të trajnojnë efektivat e policisë që do të merren me dhunën në familje.

Bashkitë dhe Komunat kane detyrimin ligjor të krijojnë strukturat e shërbimit social për dhunën në familje, të ngrenë qendra sociale dhe rehabilitimi për viktimat dhe dhunuesit, të bëjnë referim, orientim, shoqërim, transportim të viktimave për në shërbimet e tjera, t'i lëshojnë viktimës dhe gjykatës dokumenta shkresore, të paraqesin kërkesën në gjykatë për Urdhër Mbrojtjeje për të mitur dhe për Urdhër Mbrojtjeje të Menjëhershme, të marrin pjesë në gjykim për lëshimin e Urdhërit të Mbrojtjes për të miturit, të sigurojnë zbatimin e vendimeve gjyqësore, të instalojnë një linjë telefonike 24-orëshe, e cila më pas krijon lidhje me njësitë lokale, policinë, urgjencat mjekësore dhe organizatat jofitimprurese duke vendosur në këtë mënyrë edhe koordinimin mes tyre.

Në zbatim të ligjit nr.9669/2006, në vitin 2011 është miratuar Vendimi i Këshillit të Ministrave për ngritjen e mekanizmit kombëtar të referimit për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare. Sipas këtij akti nënligjor duhet që në nivel bashkie dhe qarku duhet të ketë struktura të posaçme që menaxhojnë dhe referojnë raste të viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare. Sipas të dhënave të përcjella zyrtarisht nga MPCSSH B janë ngritur deri në muajin maj 2011, mekanizmat vetëm në 17 bashki, ndërkohë që deri në fund të vitit do të ngrihen edhe në 10 bashki të tjera. Pra ngritja dhe shtrirja e këtij mekanizmi në të gjithë territorin e RSH është ende në proces, megjithëse ka kaluar më shumë se një vit nga nxjerrja e aktit nënligjor, si dhe nga hyrja në fuqi e tij. Disa njësi të qeverisjes vendore (në nivel bashkie), janë bërë promotorët e zbatimit me përgjegjshmëri dhe seriozitet të këtij detyrimi duke emëruar punonjës të çështjeve gjinore dhe të dhunës në familje, proçes ky i paraprirë nga ndryshimi i strukturës. Roli i këtyre punonjësve është i një rëndësie shumë të madhe për procesin e zbatimit dhe monitorimit të politikave gjinore, si një prioritet i qeverisjes, i procesit të anëtarësimit në BE dhe i objektivave të mijëvjeçarit. Zyrat e Shërbimeve Sociale pranë bashkive dhe komunave dhe qendrat e shërbimeve për rehabilitimin e viktimave të Dhunës duhet të mbështesin dhe referojnë rastet në aktorë të tjerë, por edhe duke paraqitur kërkesat për urdhra mbrojtje siç parashikohet në ligj dhe zbatimin e vendimeve të Gjykatës për lëshimin e urdhrave të Mbrojtjes.

Ndërkohe MPCSSH B në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile po punon për trajtnimin e mekanizmave të ngritur (atje ku ato janë konstituar tashmë), apo edhe për ndërgjegjësimin për ngritjen e tyre nga njësitë e qeverisjes vendore (atje ku ato nuk janë ngritur ende).

Ne bazë të Ligjit Nr.9669, datë 18.12.2006 “Për Masat ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare”¹⁷, në rast të dhunës në familje, viktimat mund t’i drejtohet me anë të një kërkesë postës së policisë më të afërt (të zonës ku banon ose ndodhet), njësisë përkatëse vendore (komunë, bashki), qendrës shëndetësore të zonës ku banon apo ndodhet ose me kërkesë-padi gjykatës së rrethit të vendbanimit, vendndodhjes së saj ose të dhunuesit/es, për të marrë masat e nevojshme. Çdo person që konstaton një rast të ushtrimit të dhunës në familje mund t’u drejtohet me anë të një kërkesë autoriteteve të mësipërme për të ndërmarrë masat e nevojshme.

Në ligjin 9669/2006 është parashikuar edhe detyrimi për ngritjen e një Qendre Kombëtare të Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje. Ky institucion reziudencial i përkujdesjes shoqërore është ngritur në bazë të Urdhrit të Kryeministrit nr.36, datë 23.03.2010, në mbrojtje të grave të dhunuara dhe pa asnjë përkrahje. Gratë dhe fëmijët akomodohen në këtë institucion të shoqëruar nga Policia e Shtetit, me urdhër mbrojtje ose urdhër të menjëhershëm mbrojtje nga gjykata nga e gjithë Shqipëria. Ky institucion është konceptuar si një Qendër e hapur ku gratë janë të lira të lëvizin gjatë ditës, si dhe fëmijët të frekuentojnë shkollën afër qendrës.

Gjithashtu është miratuar edhe VKM nr.505, datë 13.07.2011 “Për miratimin e standarteve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për viktimat e dhunës në familje, në qendrat rezidenciale, publike dhe jo publike”, parashikon të gjitha detajet e funksionimit konform standarteve të caktuara dhe shprehura qartë në ligj dhe akte nënligjore.

Në nenin 7 të ligjit 9669/2006 është parashikuar detyrimi i njësive të qeverisjes vendore për të ngritur në nivel vendor, qendra sociale dhe të rehabilitimit për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare.

Procesi i ngritjes së këtyre qendrave kërkon një vlerësim dhe vendimarrje të strukturave të njësive të qeverisjes vendore. Qendrat duhet të jenë të konceptuara dhe të funksionojnë si shërbime komunitare ditore, ose si institucione rezidenciale të përkujdesit shoqëror, në bazë të përcaktimeve të ligjit 9355.2005 “Për ndihmën ekonomike dhe shërbimet shoqërore” dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij. Ndërkohë në zbatim të ligjit të sipërpërmendur pranë qarqeve janë ngritur Komitetet e Vlerësimit të Nevojave për Shërbime Sociale, të cilat bazuar në kërkesat dhe nevojat që ka komuniteti (bashkia apo komuna përkatëse), vlerësojnë mundësinë e ngritjes

¹⁷ I ndryshuar me Ligjin nr.9914 date 12.05.2008, si dhe Ligjin nr.101329 date 30.09.2010.

së një shërbimi rezidencial të përkujdesit shoqëror në nivel qarku apo edhe në njësinë e qeverisjes vendore. Ajo çfare është e rëndësishme është që, njësitë e qeverisjes vendore, duke qenë se shërbimet shoqërore janë funksione të vetë bashkive dhe komunave, sipas nenit 10 të ligjit 8652/2000, bazuar në të ardhurat që ato mbledhin duhet të programojnë fonde të posaçme për ngritjen e shërbimeve në territorin ku ato kanë juridiksionin e tyre

Ministria e Shëndetësisë dhe strukturat e saj, në zbatim të Ligjit nr.9669, date 18.12.2006 ‘Per masat ndaj dhunes ne mardheniet familjare’ ka miratuar:

- Urdhërin nr.13, dt.23.01.2008 i Ministrit të Shëndetësisë “Per paisjen e personave të dhunuar në mardheniet familjare me raportin përkatës:
- Urdhërin nr.14, dt.23.01.2008 i Ministrit të Shëndetësisë “Per evidentimin e rasteve të dhunes në mardheniet familjare në regjistrin dhe kartelen individuale për rastet e dhunes në familje”
- Urdhërin nr. 410, dt.12.07.2010 i Ministrit të Shëndetësisë “Per riorganizimin e shërbimit shëndetësor dhe psikosocial për personat e dhunuar në mardheniet familjare të paraqitur në institucionet shëndetësore.
- Formulari për depistimin rutinë të dhunes në familje nga personeli shëndetësor
- Kartela individuale për viktimat që pranojnë abuzimin/dhunën
- Raporti i posaçëm për pacientin që ka pësuar dhunë.

Gjatë viteve 2010-2011 nga Ministria e Shëndetësisë janë trajnuar 1800 punonjës të shëndetësisë (mjek të përgjithshëm, infermiere e specialistë) për problemet e dhunës në familje. Në 6 qarqe janë krijuar trajnues kombëtare që shërbejnë si kapacitete kombëtare lidhur me dhunën ndaj gruas dhe fëmijës dhe në të ardhmen do të trajnojnë personelin shëndetësor të të gjithë vendit. Njëkohësisht është përfunduar udhërrëfyesi për ndjekjen e dhunës me bazë gjinore nga punonjësit e shëndetësisë. Gjatë vitit 2011 janë raportuar nga institucionet shëndetësore për rastet e dhunës 146 raste nga të cilët 84 prej tyre janë fëmije.

duhet të krijojnë kapacitetet për të trajtuar rastet e dhunës në familje në urgjenca dhe qendra shëndetësore (komuna e bashki), të ofrojnë ndihmën mjekësore dhe psikologjike në çdo kohë të kryejnë ekzaminimet mjekësore në çdo kohë, të pajisin viktimën me një raport mjekësor, të referojnë/orientojnë viktimën për në shërbimet e tjera (n 7/2/d), por edhe ta

shoqërojnë apo transportojnë atë (n 8/3/b dhe c), t'i paraqesin gjykatës dokumente të çertifikuara. Për Ministrinë e Shëndetësisë, mbrojtja e shëndetit të gruas përbën një prioritet.

Ministria e Drejtësisë adreson çështjet e dhunës në familje nëpërmjet shërbimit mjeko-ligjor, përmbarrimit dhe ndihmës juridike. Puna duhet perqendruar në këto drejtime, sigurimi i të gjithë atyre që preken nga dhuna në familje dhe përgjegjësia e dhunuesve para ligjit për veprimet e tyre. Sigurimi i një përgjigjeje të qëndrueshme dhe efektive të policisë për çdo incident të raportuar të dhunës në familje. Përfshirja e viktimave të dhunës në familje në procedurat e mbrojtjes së dëshmitarit, etj.

Shërbimi mjeko-ligjor ka si detyrë, të trajtojë ekspertët për dhunën në familje dhe ndaj fëmijëve, t'u sigurojë ekspertëve bazën materiale, të bëjë ekzaminimin dhe t'i japë një kopje viktimës, të paraqitet në gjykatë si ekspert.

Detyrat e Shërbimit Përmbarrimor Gjyqësor janë, të trajtojë përmbarruesit për ekzekutimin e Urdhërit të Mbrojtjes dhe Urdhërit të Mbrojtjes së Menjëhershme, të sigurojë përmbushjen e tyre, të ndër marrë të gjitha veprimet e duhura.

Detyrat e Komitetit Shtetëror të Ndihmës Juridike janë të sigurojë mbrojtje ligjore falas, të sigurojë një listë avokatësh të trajnuar që ofrojnë këtë shërbim. Të gjitha organet e sipërpërmenduar kanë detyrimin ligjor për t'iu përgjigjur çdo rasti, dhe për ta trajtuar në bazë të specifikave të secilit organ. Po kështu, ato kanë detyrimin për të zbatuar vendimet gjyqësore, për të rregjistruar dhe reflektuar gjithçka në dokumentacion dhe për të bashkëpunuar me strukturat e tjera. Ato kanë përgjegjësi administrative dhe penale për mospërmbushjen e këtyre detyrimeve.

Gjykata shqyrton kërkesat për Urdhërin e Mbrojtjes dhe Urdhërin e Mbrojtjes së Menjëhershme, siguron zbatimin e këtij ligji dhe ligjeve të tjera, vepron sipas parimeve të paanësisë, ligjshmërisë, mosdiskriminimit, mbështetjes në prova dhe të respektojë etikën profesionale, merr masat e organizimit të brendshëm administrativ për t'iu përgjigjur në kohë (urgjent) viktimave që i drejtohen asaj si dhe për të krijuar siguri në mjediset e gjykatë, trajnon gjyqtarët për njohjen e ligjit për dhunën në familje, trajnon stafin për t'iu përgjigjur viktimave sipas ligjit dhe rregullave të etikës.

Mosmarrëveshjet familjare janë në thelb konflikte që përfshijnë anëtarët e familjes.

IV.3.Zhvilline në parandalimin e dhunës në familje dhe asistencës ndaj viktimave të saj.

Gjatë periudhës 2007-2010 ka pasur zhvillime të dukshme në drejtim të luftës kundër dhunës ndaj grave, si në çështje të rritjes së ndërgjegjësimit në lidhje me parandalimin për dhunën në familje, ashtu edhe me përgjigjen e strukturave ndaj rasteve të dhunës.

1.Me mbështetjen edhe të Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim, janë miratuar akte nënligjore në zbatim të Ligjit kuader. Vlejnë për t'u përmendur me këtë rast aktet e nxjerra nga Ministri i Shëndetësisë, Ministri i Brendshëm dhe Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit. Kjo ka bërë që si përgjigja e këtyre institucioneve ndaj rasteve të dhunës, ashtu edhe mbajtja e të dhënave dhe regjistrimi i këtyre rasteve të jetë më i strukturuar dhe orientuar. Prokurorja e Përgjithshme¹⁸ nxori një qarkore për prokurorët, për të tërhequr vëmendjen dhe dhënë orientime lidhur me zbatimin e drejtë të ligjit “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, si dhe legjislacionit penal që gjen zbatim në këto raste.

2.Në zbatim të planit të veprimit, janë ngritur njësitë, sektorët apo seksionet përgjegjëse për çështje të dhunës në familje pranë institucioneve përkatëse të Ministrisë së Brendshme, Policisë së Shtetit dhe Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, të cilët, në zbatim të planit të veprimit të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Dhunën në Familje, janë trajnuar në lidhje me dukurinë e dhunës, shkaqet e saj si dhe detyrimet që u lindin këtyre strukturave nga ligji “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”.

3.Janë trajnuar nëpunësit civilë në organet e qeverisjes vendore, punonjës të shëndetësisë dhe arsimit, të organizuara nga Drejtoria e Politikave të Shanseve të Barabarta pranë MPÇSSHB, Ministria e Shëndetësisë dhe nga Instituti i Trajnimeve të Administratës Publike, në kuadrin e programit të përbashkët të Kombeve të Bashkuara për barazinë gjinore dhe kundër dhunës në familje.

¹⁸ *Ne fund të Dhjetorit 2010*

Gjykata, brenda 24 orëve pas lëshimit të urdhrimit të mbrojtjes me vendim gjykate, u dërgon nga një kopje të tij personave në vijim: viktimës dhe personave të tjerë të shënuar në vendim; prokurorit, nëse ka bërë kërkesë; zyrës së shërbimeve sociale të njësisë vendore, ku janë me banim të përhershëm apo të përkohshëm viktimat dhe personat e tjerë të përmendur në vendim; komisarit të policisë në rajonin ku janë me banim të përhershëm apo të përkohshëm viktimat dhe personat e tjerë të përmendur në vendim.

Si rezultat i trajnimeve në shkallë të gjerë, edhe puna e këtyre strukturave ka treguar disa arritje. Po kështu, një rritje pozitive që nga fillimi i zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Barazim Gjinor dhe Dhunën në Familje 2011-2015, evidentohet për rastet që denoncohen në polici. Të dhënat zyrtare¹⁹ dëshmojnë për një rritje të konsiderueshme, si të rasteve të dhunës në familje të raportuara në polici, ashtu edhe një rritje të numrit të kërkesave për urdhra mbrojtjeje të përgatitura dhe dërguara nëpër gjykata nga strukturat policore.

Kuvendi i Shqipërisë plotësoi boshllëkun ligjor me nxjerrjen e ligjit nr.10039, datë 22.12.2008 “Për ndihmën juridike”, ku parashikohen kushtet, lloji i ndihmës ligjore, mënyra dhe procedura që duhet të ndiqet për dhënien e ndihmës juridike, profesionalizmit të personave që japin ndihmë juridike, cilësia, efikasiteti dhe efektiviteti i kësaj ndihme, etj. Edhe në këtë ligj parashikohet shprehimisht se ndihma juridike nga shteti jepet nga avokatë të autorizuar sipas ligjit, dhe në kushtet e parashikuara në ligj. Të drejtën për të përfituar ndihmë juridike e kanë personat të cilët kërkojnë të mbrohen me avokat në procedime penale, në të gjitha fazat e tij dhe për shkak të pamundësive financiare, pasi nuk kanë mundësi të zgjedhin vetë një avokat mbrojtës ose që kanë mbetur pa të. Të drejtën për ndihmë juridike nga shteti e kanë edhe personat që kanë për gjykim një çështje civile, ose administrative, që nuk kanë mjete të mjaftueshme për të paguar një avokat, ku futen personat që përfshihen në programet e mbrojtjes sociale, ku padyshim përfshihen dhe gratë e dhunuara.

V. Kompetencat e Avokatit të Popullit dhe veprimtaria në mbrojtje të të drejtave të grave

¹⁹ Nga Sektori i Mbrojtjes së të Miturve dhe kundër Dhunës në Familje pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

Avokati i Popullit bazuar në kompetencat e parashikuara në Ligjin nr.8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", plotësuar me Ligjin nr.8600, datë 10.04.2000, ndryshuar me Ligjin nr.9398, datë 12.05.2005 mund të fillojë shqyrtimin e një çështjeje në dy forma:

1. Forma e parë ka të bëjë me ankesat, apo kërkesat dhe njoftimet që paraqesin drejtpërsëdrejti individët pranë zyrës së Avokatit të Popullit.
2. Kuadri ligjor i mësipërm i njeh të drejtën institucionit për fillimin e shqyrtimit të çështjes me nismën e tij, për rastet e bëra publike. Kështu ligji nr.8454, datë 04.02.1999, në nenin 13 parashikon se: Avokati i Popullit fillon procedurën e shqyrtimit të çështjes me nismën e vet për raste të vecanta të bëra publike, por me pëlqimin e të interesuarit, ose të dëmtuarit".

Lidhur me të drejtat e grave në përgjithësi, Avokati i Popullit ka ndjekur ndër të tjera edhe zbatimin në Shqipëri të nenit 7 të Konventës CEDAË, në drejtim të eliminimit të diskriminimit të pjesëmarrjes së gruas në jetën politike. Edhe pse ne mjaft shtete që kanë parashikuar kuota, nuk janë vendosur limite kohore për zbatimin e tyre, duket se tendenca e fundit është për të mbeshtetur me teper sistemet e kuotave të perkohshme. Këto masa merren me qëllim që të tregohet perkohshmeria e aksioneve politike të shtetit, deri në zhdukjen e të gjitha barrierave që ekzistojnë në realitetin patriarkal zgjedhor. Një gjë e tillë duket qartë dhe në rekomandimet që Komiteti i Kombeve të Bashkuara për eliminimin e diskriminimit kundër Grave, i ka bërë shtetit shqiptar pas raportimeve të bëra për zbatimin e Konventës së OKB "Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit për gratë". Pra, vlerësohet se pjesëmarrja e grave në jetën publike dhe politike në Shqipëri si dhe në procesin e vendimarrjes mbetet e kufizuar.

Gjithashtu nga Avokati i Popullit është ofruar mbrojtje për viktimat në rastet e diskriminimit të grave nga ana e autoriteteve shtetërore dhe institucioneve të tjera, si dhe në rastet e ushtrimit të dhunës në familje.

Për periudhën 2003-2007, Zyra e Avokatit të Popullit ka trajtuar 6 raste, kur subjektet të cilat janë ankuar, gra apo vajza kanë pretenduar për mosveprim të organeve të policisë, apo prokurorisë në drejtim të rasteve të denoncuar prej tyre.

Pas hetimit të institucionit vetëm në një rast është provuar ushtrimi i dhunës në familje për një shtetase, e cila si pasojë e dhunës ka tentuar të vetvritet.

Ky rast është regjistruar me iniciativë si rast i veçantë dhe është bërë publik në media. Në përfundim të hetimit të kësaj çështjeje, nga ana e Institucionit të Avokatit të Popullit i është paraqitur një rekomandim Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit në të cilin kërkohet:

1. Rishikimi i Planeve të dislokimit të shërbimeve të Reparteve të Policisë së Rendit në situatë normale, në Komisarjatin e Policisë Elbasan dhe në të gjithë Komisarjatet e Policisë në shkallë vendi, si dhe plotësimi i tyre me numrin e punonjësve të policisë të domosdoshëm për të kryer sa më mirë dhe me cilësi të lartë detyrat funksionale.
2. Rasti i varjes së mbetur në tentativë të shtetases dhe pakujdesia e treguar nga punonjësit e policisë së komisarjatisë të Elbasanit të përgjithësohet në të gjitha organet e policisë vendore, me qëllim rritjen e cilësisë së shërbimit policor dhe parandalimin e ngjarjeve të ngjashme në të ardhmen.
3. Në vazhdimësi të trajtimit të kësaj ankese, institucioni i është drejtuar me rekomandim Zv.Ministres së Brendshme për marrjen në mbrojtje dhe strehimin e shtetases në Qendrën Kombëtare Pritëse të Viktimave të Trafikimit.

Rekomandimet u shqyrtuan, u vlerësuan me seriozitet dhe u mirëpritën nga këto organe.

Po kështu Avokati i Popullit në rolin e Mekanizmit Kombëtar për parandalimin e torturës inspektoi në Shtator 2008 “Qendrën Pritëse të Viktimave të Trafikut”, në Linzë, Tiranë dhe i rekomandoi Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta:

1-Hartimin e një rregulloreje të veçantë në gjuhën shqipe dhe angleze për organizimin dhe funksionimin e jetës së brendshme për personat e strehuar përkohësisht në këtë qëndër.

2-Ekzaminimin fillestar të emigrantëve me një komision mjekësor dhe hapjen e kartelave të veçanta mjekësore individuale.

3-Krijimin e kushteve financiare për mbulimin e shpenzimeve të një përkthyesi me kohë të plotë ose të pjesshme në varësi të nevojave të Qendrës.

Kjo Qendër ka qenë në vijimësi vit pas viti, objekt i monitorimit të Institucionit të Avokatit të Popullit dhe janë bërë rekomandimet përkatëse për konstatimet e bëra nga ana jonë.

Me iniciativën e Avokatit të Popullit, është bërë në periudhën 10.04.2012-12.04.2012, një inspektim në Qendrën Kombëtare të Trajtimit të Viktimave të Dhunës, Kamëz, Tiranë. Ky inspektim mori shkas nga ankesa e bërë nga disa gra të strehuara në këtë Qendër, si dhe nga transmetimi i një kronike televizive, për trajtimin dhe kushtet e ofruara në këtë institucion. Pas inspektimit rekomandoi si më poshtë:

1. Shkarkimin nga detyra të drejtueses së Qendrës, duke zgjidhur menjëherë kontratën e punës, për shkaqe të justifikuara në bazë të nenit 153 të Kodit të Punës.
2. Marrjen e masave për riorganizimin e stafit dhe shtimin në organikë si shumë të nevojshëm dhe domosdoshëm të një juristi dhe një psikologeje.
3. Marrjen e masave për ruajtjen dhe shoqërimin me njerëz të specializuar, me mjetin e institucionit të grave dhe fëmijëve kur ato dalin jashtë Qendrës.
4. Trajnimin e vazhdueshëm të stafit në lidhje me trajtimin dhe komunikimin që ato duhet të kenë me gratë dhe fëmijët e strehuar në këtë Qendër.
5. Hartimin e një rregulloreje të brëndshme, shumë të nevojshme ku të përcaktohen qartë të drejtat dhe detyrimet e stafit dhe grave të strehuara, rregulla të cilat të mos bien ndesh me Kushtetutën dhe liritë themelore të njeriut.
6. Detyrimin e Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, për nxjerrjen e udhëzimit për zbatimin e standarteve sipas VKM nr.505, dt.13.07.2011.
7. Përmirësimin për trajtimin ushqimor konform kuotave me shumëllojshmëri dhe produkteve stinore.

Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta në vijim të rekomandimit të datës 19.04.2012 mbi marrjen e masave për përmirësimin e kushteve dhe trajtimin të grave dhe fëmijëve që janë të akomoduar në Qendrën Pritëse të Viktimave të Dhunës na informon se:

Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta ka ndjekur dhe ka analizuar me interes të lartë rekomandimet e derguara pranë saj, për vetë specifikën tepër delikate të statusit viktime të dhunës në familje, duke marrë masat si më poshtë vijon:

1. Në lidhje me pikën e parë të rekomandimit ku kërkohet shkarkimi nga detyra e drejtueses së Qendrës, informojnë se që prej dt.09.05.2012, është larguar drejtoresha e institucionit dhe komanduar në detyrën një tjetër person.

2. Per shtimin ne organike te nje juristi dhe psikologu sqaronin se struktura e Sherbimit Social Shteteror miratohet me urdher te Kryeministrit. Ne vazhdimesi do merren masa ku ky rekomandim do t'i referohet Keshillit Administrativ te Sherbimit Social Shteteror, per te bere ndryshimet e nevojshme si organ vendimmarres. Ne zbatim te VKM nr. 505, date 13.07.2011, ku Qendra te ofroje asistence ligjore per perfitueset dhe ndihmen e psikologut te mirfillte, Drejtori i Pergjithshem i Sherbimit Social Shteteror ka urdheruar psikologun dhe juristin e Qendres Kombetare Pritese te Viktimave te Trafikimit, te punojne dy dite ne jave ne Qendren Kombetare te Viktimave te Dhunes ne Familje, dhe ne rastet e domosdoshme per ofrimin e ketij sherbimi.

3. Në zbatim të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen dhe sigurinë e viktimave të dhunës institucionet përgjegjëse janë institucionet e rendit publik të cilët zbatojnë vendimet e gjykatës. (Urdhërat e Mbrojtjes). Qendra është e pajisur me automjet lëvizës i cili është vënë në dispozicion të përfituesve sipas standardit Nr.2, të VKM Nr.505 datë 13.07.2011 “Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për viktimat e dhunës në familje, në qendrat rezidenciale, publike dhe jo-publike”.

4. Drejtoria e Politikave të Shanseve të Barabarta dhe Familjen në bashkëpunim me PNUD-in, në kuadër të zbatimit të Strategjisë Kombëtare të Barazisë Gjinore dhe dhunës në familje, ka zhvilluar dy trajnime për stafin e kësaj Qendre: 17-23 maj 2011 me temë: “Të ndihmojmë të mbijetuarit e dhunës në familje” dhe “Kuadri rregullator i Qendrës Kombëtare të trajtimit të viktimave të dhunës”.

5. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror miratoi rregulloren e brendshme te organizimit dhe funksionimit të Qendrës Kombëtare të Viktimave të Dhunës në Familje, me Nr.137/2 Prot, dt.26.04.2012 bazuar në legjislacionin në fuqi.

6. Drejtoritë e Politikave në MPCSSHB në bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare kanë përgatitur manualin për zbatimin e VKM Nr.505 datë 13.07.2011 “Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për viktimat e dhunës në familje, në qendrat rezidenciale, publike dhe jo-publike”. Në zbatim të Urdhërit Nr.87 datë 15.05.2012 do të dale edhe udhëzimi i miratuar nga Ministri i Punës Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

7. Në zbatim të Udhëzimit Nr.1547 datë 27.08.2009 “Për nivelin e kuotave të shpenzimeve për ushqim në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesit shoqëror” nga raportimi i Inspektorit të Punës dhe Çështjeve Sociale, si dhe në zbatim të standardeve të përkujdesit social të viktimave të dhunës në familje, ka vlerësuar pozitivisht respektimin e kuotave. Niveli i kuotave ushqimore në institucionet publike, rezidenciale dhe komunitare bazuar në nenin 24 të Ligjit nr.9355 dt.10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” miratohen nga Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale.

Problem tjetër i evidentuar edhe në Raportin vjetor 2011 të punës së Avokatit të Popullit është dhe fakti që: *“Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe kundër Dhunës me Bazë Gjinore dhe asaj në Familje 2011-2015 e miratuar me VKM nr.573 date 16.06.2011, ka parashikuar ndër të tjera dhe problemin e nënkontraktimit të OJF-ve për të ofruar shërbimet përkatëse për viktimat e kësaj dhune.*

Mundësia dhe detyrimi për të bashkëpunuar ndërmjet organeve të qeverisjes vendore dhe qendrore për shërbimet sociale, është vendosur qartësisht në Ligjin nr.9669, date 18.12.2006 “Per masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”. Por zbatimi rigoroz i këtij ligji kërkon financim të organizatave të shoqërisë civile nga organet kompetente shtetërore, në mënyrë që ato të kryejnë siç duhet shërbimet për viktimat e dhunës në familje, per parandalimin e saj dhe rehabilitimin e dhunuesve”.

VI. Konsultimi i raportit

Raporti i është dërguar për mendim organizatave joftimprurëse që ushtrojnë aktivitetin e tyre për mbrojtjen e të drejtave të grave, të cilat bashkëpunojnë ngushtësisht me institucionin e Avokatit të Popullit. Organizatat e sipërpërmendura janë shprehur dakort lidhur me raportin dhe kanë dhënë disa sugjerime për përfshirjen në të të çështjeve apo problematikave të caktuara, sugjerime të cilat janë përfshirë në brendinë e raportit.

Gjithashtu raporti i është dërguar për mendime edhe Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës. Ministrisë së Shëndetësisë.

Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta në përgjigjen e saj, dërguar në datë 18.05.2012 ka konstatuar se nga ana e

Avokatit të Popullit është bërë një analizë fenomenit të dhunës në familje, të politikave, legjislacionit në fuqi, të mekanizmit për barazinë gjinore dhe dhunën në familje si dhe të institucioneve të tjera përgjegjëse, dhe përpjekjet e institucionit të Avokatit të Popullit për trajtimin e rasteve të hetuara administrativisht për mbrojtjen dhe respektimin të të drejtave të viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare. Gjithashtu prej saj është dhënë informacion lidhur me zhvillimet më të fundit për këtë çështje, informacion i cili më tej ka gjetur pasqyrim në këtë raport.

Lidhur me nëpunësit gjinorë ministria ka theksuar se ka *“...vazhduar puna për institucionalizimin e rrjetit të nëpunësve gjinorë në ministritë dhe bashkitë e vendit.*

Aktualisht në nivel qendror, vetëm Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Mbrojtjes e kanë përcaktuar me strukturë një nëpunës të çështjeve të barazisë gjinore në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga Ligji për Barazinë Gjinore.

Ndërkohë në ministritë e tjera ka pikë kontakti joformale për çështjet gjinore. Në bashkitë e vendit nga 65 bashki 16 janë me strukturë të posaçme. Në disa bashki ka dhe zyra të posaçme të barazisë gjinore.

Ministria e Shëndetësisë është shprehur se u njoh me raportin, si dhe ka paraqitur disa informacione shtesë të perditësuara dhe të detajuara mbi disa nga masat që Ministria e Shëndetësisë ka marrë për vlerësimin dhe parandalimin e dhunës në familje, dhunës me bazë gjinore. Informacionet e përcjella prej tyre janë pasqyruar në raport

Ministria e Brendshme si dhe Ministria e Arsimit dhe Shkencës, nuk kanë dërguar mendime lidhur me raportin.

VII.Konkluzione dhe Rekomandime

Rekomandimi 11 i BE për Shqipërinë përcakton se duhet:

*“Të bëhen hapa konkrete në forcimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, sidomos të grave, fëmijëve dhe romëve, si dhe në zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminim”. Ndaj në kuadër të *organizimit të fushatave të ndërgjegjësimit për parandalimin e dhunës gjinore dhe dhunës në familje*”, *puna e Institucionit të Avokatit të Popullit ndër të tjera do të vijojë me organizimin e ditëve të hapura, inspektimet e vazhdueshme dhe në qendra ku**

strehohen gratë e trafikuar. Gjithashtu objekt i punës në vazhdim nga Institucioni i Avokatit të Popullit, do të jetë edhe vlerësimi dhe monitorimi i zbatimit të detyrimeve ligjore dhe nënligjore nga autoritetet shtetërore përgjegjëse sipas fushës së veprimtarisë së tyre.

1. Bashkëpunimi i vazhdueshëm i Avokatit të Popullit me organizatat jofitimprurëse, që së fundmi është materializuar në marrëveshjet e përbashkëta të bashkëpunimit, do të përqëndrohet kryesisht në trajtim (referim) rastesh, ndërgjegjësim komuniteti lidhur me të drejtat e grave-aktivitete të përbashkëta, etj, dhe hartim rekomandimesh. Marrëveshjet e bashkëpunimit të Avokatit të Popullit me organizata të shoqërisë civile në mbrojtje të të drejtave të grave, do të bëjnë të mundur që vetë shoqëria civile “ta përdorë efektivisht Avokatin e Popullit për të përçuar mesazhe të rëndësishme lidhur me gjendjen e të drejtave të grave ndaj të cilave duhet ndërhyrje ligjore, administrative, etj”.

2. Është rritur numri i individëve që i drejtohen gjykatës për arsye të dhunës si dhe numri i urdhërmbrojtjeve të lëshuara prej tyre. Vihet re që ndër vitet e zbatimit, ka pasur një zgjerim të numrit të gjykatave që kanë lëshuar urdhra mbrojtjeje për viktimat e dhunës në familje, duke mos mbetur vetëm në gjykatat e qyteteve të mëdha, por edhe në ato të rretheve më të vogla. Shtimi i numrit të vendimeve për urdhrat e mbrojtjes të lëshuara nga Gjykata tregon se është rritur ndërgjegjësimi, reagueshmëria dhe besimi i viktimave të dhunës në sistemin e mbrojtjes. Mirëpo, shpejtësisë së gjykatës nuk i përgjigjen strukturat e përmbartimit, të cilat duket se e gjejnë të vështirë në terren zbatimin e vendimeve gjyqësore.

3. Dhuna në familje është një fenomen mjaft i përhapur në shoqërinë shqiptare dhe si rrjedhojë, është përgjegjësia e shtetit, komunitetit dhe individëve të ndërmarrin veprimet e nevojshme për ta ndaluar atë. Është e domosdoshme që qeveria të ndërmarrë inisiativat e duhura kundër këtij fenomeni në mënyrë që të respektojë dhe plotësojë të drejtat themelore të grave dhe fëmijëve si pjesë e të drejtave të njeriut. Pavarësisht nga inisiativat dhe aktivitetet e organizatave të ndryshme, veprimet e ndërmarra nga shteti kanë mundësinë të unifikojnë dhe të konsolidojnë këto përpjekje dhe pse jo t'i nxisin dhe promovojnë.

4. Procesi i dëmshpërblimit të gruas që ka pësuar torturë ose dhunë seksuale, ose forma të tjera të keqtrajtimin, në praktikë është i vakët. Padi civile në procesin penal përdoret shumë rrallë. Faktori kryesor është mendësia sipas

së cilës, “nderi nuk mund të blihet me para”, por ka, gjithashtu, edhe një sërë faktorësh të tjerë.

5. Përveç punës që bëjnë disa organizata jofitimprurëse për ndërgjegjësimin dhe gjetjen e rrugëve konkrete për përmirësimin e situatës, duhet që të gjenden mjete efektive në kuadrin e një mekanizmi, për të garantuar që të ruhen dhe zbatohen të drejtat e grave, për të përmirësuar trajtimin dhe pozitën e femrave në familje dhe në shoqërinë shqiptare. Organet që merren me dhënien e drejtësisë duhet të shohin me prioritet rastet kur pjesë e keqtrajtimit dhe e dhunës së ushtruar janë gratë dhe vajzat. Ato shpesh detyrohen të heqin dorë nga akuza për një arsye apo tjetër. Shumë krime të ndodhura ndaj grave vite më parë, janë akoma pa autor.

6. Fuqizimi ekonomik i grave përbën një ndër kushtet themelore për arritjen e barazisë gjinore, reduktimin e dhunës me bazë gjinore.

7. Integrimi gjinor duhet të jetë pjesë e gjithë politikave sociale, ekonomike dhe politike në Shqipëri për të pasur arritjen e një zhvillimi të qëndrueshëm nëpërmjet shfrytëzimit të potencialit të plotë njerëzor të vendit, sikurse dhe garantimit të gëzimit të këtyre arritjeve nga të gjitha grupet shoqërore.

8. Ngritja në të gjithë njësitë e qeverisjes vendore, sipas përcaktimeve të akteve nënligjore (qarqe dhe bashki) e mekanizmave të referimit të rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare

9. Ngritja dhe forcimi i mekanizmave për barazinë gjinore në nivel qendror dhe vendor, veçanërisht shpejtimi i procesit për emërimin e nëpunësve gjinorë në strukturat e Ministrive dhe të nëpunësve vendorë për çështjet gjinore në bashkitë e vendit.

10. Dhënia prioritet politikave lidhur me pjesëmarrjen e grave dhe vajzave nga skemat e mbështetjes me të ardhura, në programe aktive punësimi, formimi profesional dhe ritrajnimi.

11. Zbatimi i Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë datë 2.12.2010 “Për luftën kundër dhunës ndaj gruas dhe rritjen e dimensionit parlamentar të luftës kundër dhunës në familje”.

12. Ngritja e shërbimeve të përkujdesit shoqëror dhe të rehabilitimit për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare, nga njësitë e qeverisjes vendore me të ardhurat e tyre.

13. Zbatimi i masave të parashikuara në Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe kundër Dhunës me Bazë Gjinore dhe asaj në Familje 2011-2015, të cilat kërkojnë krijimin e procedurave dhe mundësive për nënkontraktimin e OJF-ve, për të ofruar shërbimet përkatëse për viktimat e kësaj dhune.